



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 138, datë 30.09.2020

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TE
ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE
E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE
KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 13 dhe 14 të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, nenit 25, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe neneve 9 dhe 11 të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe rregjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e riemërimit të zj. Estela Koçi, zj. Vjosa Bodo (Mujo) dhe z. Eugen Nuri, në pozicionin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Credins Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., për një periudhë 3 (tre) vjeçare, deri më datë 24.07.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**